



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR.1 sh.a

Date. 22.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Mall

“Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”.
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

31681410-0, 44115210-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 3 758 700 (tre milion e shtatëqindë e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqindë) leke pa T.V.SH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Rezidenca Studentore Universitare Nr.1 sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; ne vleren 75,174 (shtatëdhjetë e pesë mijë e njëqindë e shtatëdhjete e katër) lekë*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, te ndryshuar, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2021, 2022, 2023**) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të ketë një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht **1 503 480 (një million e pesëqindë e tre mijë e katërqindë e tetëdhjetë)** lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës;

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" te ndryshuar.

2.3 Kapacitetet teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet (vlera e pritshme e kontratave) ose **751 740 (shtatëqindë e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqindë e dyzetë)** lekë pa tvsh.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Ose

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave

të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar sipas standarteve ISO 9001-2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, e vlefshme ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë,: Është një standart ndërkombëtarë i dedikuar për sistemet e menaxhimit të cilësisë, i cili përshkruan një kornizë në përmirësimin e cilësisë për çdo organizatë që kërkon të ofrojë produkte dhe shërbime konform kërkesave dhe pritshmërisë së klientëve/palëve të interesuara në mënyrë më efektive të mundshme. Ndër të tjera ky standart harmonizohet me objektivat dhe planet e RSU NR.1 në rritjen gjithnjë e më shumë të cilësisë në punët e përditshme dhe përafrimin me procedurat e ngjashme me vendet e tjera të zhvilluara.

2.3.3Ofertuesi nepermjet nje deklarate duhet te deklaroje se merr persiper furnizimin e mallrave prane AK.

Argumentimi: nenit 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteri i cili vlerësohet i nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

SPECIFIKIME TEKNIKE
PËR MATERIALE ELEKTRIKE DHE HIDRAULIKE

A. MATERIALE ELEKTRIKE

1.Karakteristikat teknike te Llampave duhet te jene si me poshte:

- a) **Llampa led 25w**, Fuqia 25 W, Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500K, Lloji portollampes: E27, Jetegjatesia: 15000-30000 ore pune.
- b) **Llampa led 15w**, Fuqia 15W, Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500 K, Lloji portollampes: E27, Jetegjatesia: 15000-30000 ore pune.
- c) **Llampa led 9w**, Fuqia 9W, Tensioni 220-240Vac, Ndricimi 6500 K, Lloji portollampes: E27, Jetegjatesia: 15000-30000 ore pune.
- d) **Llampa led, 6w**, Fuqia 6W, Tensioni 160-260Vac, Ndricimi 6500 K, Lloji portollampes: Gu10, Jetegjatesia: 15000-30000 ore pune.
- e) **Llampat 250w ,65w** duhet te plotesojne 8000-10000 ore pune.
- f) **Glob 300**: Tipi: Glob per ndricues, Materiali Plastik, Ngjyra: E bardhe.

2.Karakteristikat e Kabllit elektrik duhet te jene si me poshte:

- a) **Kabell 3 x 1.5mm**, Materiali, Baker, Temperatura e punes: +5°C - +60°C, Tensioni 450/750V, Paketimi: 100m
- b) **Kabell 3 x 2.5 mm**, Materiali, Baker, Temperatura e punes: +5°C - +60°C, Tensioni 450/750V, Paketimi: 100m
- c) **Kabell 4 x 4 mm**, Materiali, Baker, Temperatura e punes : +5°C - 60°C, Tensioni 450/750V, Paketim: 100m

3.Karakteristikat teknike të Plafoniereve të jenë si më poshtë: (Inkaso ,te jashtem)

- a) **Plafonier Led 28.5x28.5, Fuqia 24W**, Forma: Katror, Ndricimi 6500K, Jetegjatesia 20000-30000ore pune.(Te jene te kompletuar me ushqyes)
- b) **Plafonier led 18W**, Forma: Rrethor, Ndricimi: 6500K, Jetegjatesia 20000-30000 ore pune. Te jene te kompletuar me ushqyes.
- c) **Spot Brenda murit 18W**, Forma, Rrethor, Ndricimi: 6500K, jetegjatesia 20000-30000 ore pune, te montohen brenda gipsit me kllapa. Te jene te kompletuar me ushqyes.

- d) **Spot brenda murit 12W**, Forma: Rrethor, Ndricimi: 6500K, Jetegjatesia 20000-30000ore pune. Diameter 16cm, Te montohen Brenda gipsit me kllapa. Te jene te kompletuar me ushqyes.
- e) **Spot i jashtem 6W**, Forma: Rrethor, Ndricimi: 6500K, Jetegjatesia 20000-30000ore pune. Te jene te kompletuar me ushqyes)
- f) **Prozhektor Led 100w**, Tipi: Prozhektor led, Ngjyra ndricimit 6500K, Materiali: Alumin,

4.Karakteristikat teknike te automateve duhet te jene si me poshte:

- a) Automat 2P, 20A , 25A, 40A - (te jene te markes ABB ose Schneider) ose ekuivalente
- b) Automat 4P, 20 A, 25A, 40A, A63 - (te jene te markes ABB ose Schneider) ose ekuivalente

5.Karakteristikat teknike te Leshuesve duhet te jene si me poshte:

- a) **Leshues 63A 3F 4P 220v-240v** (te jene te makres ABB ose Schneider) ose ekuivalente

6.Karakteristikat teknike të Salvavitave të jenë si më poshtë:

- a) **Salvavit 4P, 40A** ~ 230v - 400v (te jene te makres ABB ose Schneider) ose ekuivalente
- b) **Salvavit 2P, 20A, 40A** - (te jene te makres ABB ose Schneider) ose ekuivalente

7. Karakteristikat teknike te Nastro e madhe duhet te jene si me poshte:

- a) **Nastro ngjyre e zeze 19x25x0.18**: Material PVC, Tipi:3M, Gjeresia 19mm, Gjatesia 25m.

8. Karakteristikat teknike te Pompe 12/6, Grup furnizimi te jene si me poshte:

- a) **Pompe uji zhytесе 0.75kWme galixhan**: Fuqia 0.75kw, Diametri ne dalje 1.5*, Gjatesia kabllit 8m, Prurja max 100l/min

Karkateristika te tjera:

9. Spine shuko 90°: Modeli 90*, Materiali Plastik, Ngjyra e bardhe,

10. Tapa falso : Numri moduleve 1, Material plastic, Tipi tape fallco, Model markash te ndryshme

11. Kuti montimi JM 2P dhe 4P: Modeli jashte muri, Material plastike, Numri moduleve 2 edhe 4.

12. Sensor levizje ndricimi modele te ndryshem jasht muri dhe gipsi.

13.Kontesator per pompat e kaldajes 28kW meret mostra ne magazine

B. MATERIALE HIDRAULIKE

Materialet hidraulike do te furnizohen sipas zerave te pasqyruara ne preventiv.

Te gjitha materialet duhet te jene cilesore dhe perpara furnizimit duhet te miratohen mostrat per secilin material pastaj te behet furnizimi .

Ne pergjithesi specifikimet e secilit material jane bere ne emertimet e tyre ne preventiv, por ne vecanti duhet te plotesohen disa kerkesa si me poshte:

- 1. Grupet e dushit:** Duhet te jene material bronxi, te kompletuar me zorra, koka dushi dhe mbajtese koka dushi.
- 2. Grupet e Lavamanit:** Duhet te jene material bronxi, te kompletuar me tuba fresibel.
- 3. Grupet e Lavapjatis:** Duhet te jene material bronxi, te kompletuar me tuba fresibel.
- 4. Sifonet me pilete:** Duhet te jene Materiali: PP (polipropilen),Te kete dhe piletën e perfshire ne paketim.
- 5. Sifon set lavapjati me 2 pileta Ø40:** Duhet te jene Materiali: PP(polipropilen),Te kete dhe piletat e perfshira ne paketim.
- 6. Kokat e dushit:** Duhet te jene me vide ne mese (te meret mostra ne magazine).
- 7. Kokat e dushit 20x20cm:** Duhet te jene material Inoksi, rezistente nga presioni dhe nxehtesia.
- 8. Zorra dushi:** Material Inoks, Tipi:Me dado bronxi, Gjatesi 150cm.
- 9. Tubat fresibel:** Te perballojne presionin 6bar, Material: Inoksi.
- 10. Rubinetat bronxi:** Te jene bronxi me leve ose pallot.
- 11. Filtra:** Duhet te jene material bronxi.
- 12. Manikotat Ø32, Ø25:** duhet te jene material plastic dhe me ngjitje.
- 13. Bulitor 500L me serpetina :** Te jete i kompletuar me te gjithe aksesoret (rezistence 9kW, Manometer presioni/temperature ,termostat, k/valvol,guarnicione,flanaxhe ,tapa).
- 14. Bolier 10Lt:** Bolier instalohet poshte lavapjates fuqi 1500W.
- 15. Sistem Wc Inkaso + kasete & buton:** Materiali polietilen + skelet I galvanizuar, Lartesi e regjistrueshme 0-35cm.te jete e kompletuar.
- 16. Pilete lineare 40cm, o40mm Inoks:** Gjeresia 40cm Shkarkimi o40, Material Inoks.
- 17. Silikon:** Transparent ngjites duhet te jete material antimyk.
- 18. Galixhanti per kaset Wc:** Lidhja me tubin fleksibel: Bronxi

19. **Kontesator per pompat e kaldajes 28Kw** Te merren mostrat ne Godinen 11-12.
20. **Reduktor presioni** – Te jene material bronxi.
21. **Zgare per Kaldajat me pellet:** Zgarat duhet te meren mostrat paraprake ne Godinat Nr.6 dhe 11-12, Materiali GIZE.
22. **Filter bronzi 2*,1 1/2', 1 1/4', 3/4:** Material Bronxi.
23. **Saracineskat** – Duhet te jene material Bronxi
24. **Rakorderit e multistrades:** Duhet te jene material bronxi.

Materialet per Lavatricet duhet te meren monstat perkatese ne Magazine.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike hartohen nga struktura të specializuara për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Lëvrimi: Brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Një nga detyrat funksionale të Drejtorisë së Shërbimeve Mbeshtetese është të kujdeset për mirëmbajtjen e godinave të RSU Nr.1. Për ushtrimin e detyrave funksionale stafi i mirembajtjes ka nevoja për pajisjen me materialet e domosdoshme elektrike dhe hidraulike. Materialet elektrike dhe hidraulike duhet të jenë sa më cilësore, ti përshtaten tërësisht specifikimeve teknike të kërkuara nga AK.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **04.11.2024, ora 12:00.**

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP

Njesia e prokurimit